Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 nëntor 2024

  
  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-214/24

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 nëntor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 56 m2, pjesë e parcelës Nr.7613-2, me sipërfaqe të përgjithshme 709.9 m2, Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna Prishtinë, pronë e NSh KBI Kosova Eksport, me parashtruesin \_\_\_\_\_ nga Prishtina.
- II. Klasifikimi i pronës të paraqitur në paragrafin I të këtij vendimi është pronë rezidenciale, ndërsa kategoria është parcelë për ndërtesë apartamentesh.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin rekomandohet aprovimi i iniciimi të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Kosova Eksport, me parashtruesin nga Prishtina.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, dhe duke qenë se rasti i plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas neneve 4.2 dhe 7.1.2 të Rregullores Nr. 04/2024, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në paragrafi I në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 nëntor 2024

  
\_\_\_\_\_  
**Mentor Hyseni**  
**Kryesues**  
**Bordi i Drejtorëve**  
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**







Nr. Ref. BD-214/25

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 nëntor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

**I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale P-280-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 6775 m<sup>2</sup>, ZK LLapnasellë, Komuna Graçanicë, pronë e KBI “Kosova Export” – “Ratar” me parashtruesin**

**II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI “Kosova Export” – “Ratar” me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij pala ka theksuar se parcela 280-1, për të cilën ka bërë kërkesë për ta blerë përmes shitjes direkte kufizohet në tri anët me parcelat private të parashtruesit të kësaj kërkesë ( ) dhe në një sipërfaqe prej afërsisht 5 ari të cilën e shfrytëzojmë ka ndërtuar objekt. Tutje pala ka theksuar se duke pasur parasysh se parcela në tri anët kufizohet me parcelat e parashtruesit të kërkesës si dhe duke pasur parasysh gjendjen në teren, parcela si objekt i kërkesës nuk është atraktive për palët e treta sepse gjendet mu në mesin e pronave private të tij. Në mbështetje të kërkesës i njëjti ka dorëzuar edhe ekspertizën gjeodezike në të cilën janë përshkruar pretendimet e tij.

Parcela sipas ekspertizës gjeodezike parcela 280-1 me sipërfaqe 6775m<sup>2</sup> në ZK LLapnasellë, Komuna e Graçanicës kufizohet: në anën veriore kufizohet me parcelën 280-3 pronë e , në anën lindore me parcelën 288-0 pronë e KBI Kosova Export, kurse në anën jugore me parcelën 281-0 dhe në pjesën perëndimore me dy parcelat 26-1 dhe 26-4 të gjitha pronë e parashtruesit të kërkesës. Brenda parcelës kadastrale ashtu sikurse është prezantuar edhe në ekspertizën gjeodezike ekziston një objekt i ndërtuar me konstruksion metalik (llamarinë) i shfrytëzuar për nevoja të kompanisë dhe në të njëjtën pjesë është shtruar me kubëza betoni. Nga Raporti i vizitës në teren, konstatohet se në këtë pjesë të parcelës kadastrale, ka të ndërtuar konstruksion metalik (llamarinë). Në anën tjetër, nuk është kontestues fakti se parcela 280-1 e cila është objekt i kërkesës rrethohet në tri anët me parcela private të parashtruesit të kërkesës, mirëpo në pjesën lindore kjo parcelë kufizohet me parcelën 288-0 pronë e KBI Kosova Export e cila përmes saj mundësohet qasja në rrugë fushore.



Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 nëntor 2024.

  
\_\_\_\_\_  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD-214/26

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 nëntor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale P. 767-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2215 m<sup>2</sup> ZK Matičan, pronë e NSh KBI Kosova Export – Ratar Prishtinë, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI “Kosova Export” – “Ratar” me parashtruesin


Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij pala ka theksuar se parcelë është në fqinjësi me pronat në të cilat e njëjta si kompani ka ndërtuar objekte banesore. Tutje, është theksuar se në pamundësi që ngastra në fjalë të privatizohet përmes tenderit publik për shkak se e njëjta është rrethuar me pronat e kompanisë si biznes privat, andaj ka kërkuar blerjen përmes shitjes direkte. Në mbështetje të kërkesës pala ka paraqitur edhe ekspertizën gjeodezike duke elaboruar pretendimet e tij lidhur me ngastrën kadastrale si dhe vendimin e caktimit të kushteve ndërtimore dhe lejen e ndërtimit të leshuar nga Komuna e Prishtinës. Parcela gjendet në ZK Matičan në Komunën e Prishtinës, konkretisht në rrugë C zonë e cila aktualisht karakterizohet me aktivitetet të ndërtimeve të larta banesore. Parcela sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndërtim dhe e njëjta ka qasje në rrugë përmes parcelës 1414-5 si rrugë e pakategorizuar si dhe është shumë afër rrugës publike Enver Maloku (Rruga C).


Në anë tjetër nuk është kontestuese se ngastra kadastrale 767-0 e cila është objekt i kërkesës kufizohet me disa parcela të kompanisë mirëpo e njëjta nuk është e rrethuar me prona private të palës ashtu sikurse pretendohet në kërkesë. Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.  
Prishtinë, më 15 nëntor 2024.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-214/27

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 nëntor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale 00980-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 4029 m<sup>2</sup> ZK Lubizhdë Prizren, pronë e NSh KBI Progres, me parashtruesin nga Prizreni.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres, me parashtruesin nga Prizreni.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se sipas deklaratës së tij pala ka theksuar se kjo ngastër kadastrale është në kufi me parcelën e tij private dhe se interesimi i palës është të bëj plane për zgjerimin e aktiviteti të tij biznesor. Po ashtu edhe Shoëroom-i i kompanisë është i vendosur përballë parcelës e cila është objekt i kërkesës. Pala ka theksuar se interesimi i tij për privatizimin e kesaj ngastre kadastrale nderlidhet me faktin se në planet tij të zhvillimit të biznesit ka paraparë që të ndërtojë edhe një shoëroom ose repartin e dytë të prodhimit-përpunimit të drurit.

Pala gjithashtu ka theksuar se KK Prizren ka paraparë rrugë me katër korsi në kete zonë andaj kjo parcelë për palën do të ishte me interes të lartë për zgjerimin e biznesit. Pala në mbështetje të kërkesës nuk ka bashkangjitur ekspertizen gjeodezike po disa ortofoto me disa shpjegime percjellese lidhur me pretendimet e tij.

Parcela gjendet në ZK Lubizhdë në Komunën e Prizrenit dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme. Në këtë parcelë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndërtime dhe po ashtu të njëjtat kanë qasje të pa penguar në rrugë publike.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 nëntor 2024.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-214/28

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 nëntor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale 00263-2 me sipërfaqe të përgjithshme nrei 2931 m2 ZK Llapnasellë, pronë e KBI Kosova Export – Ratar, me parashtruesin \_\_\_\_\_ nga Prishtina.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Kosova Export – Ratar, me parashtruesin \_\_\_\_\_ nga Prishtina.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se sipas deklaratës së tij pala ka theksuar se kjo parcelë ka rendësi të madhe për të pasi që nga viti 2016 në të ka investuar mjete financiare, duke kryer pune të shumta në të sikurse është mbushja me zhavorr, rrethoja e gjithë parcelës me muri dhe tel mbrojtës, po ashtu pala ka deklaruar se ka hapur puse për ujë me thellësi 12 metra thellësi, kanalizimi si dhe ka ndërtuar një objekt me sipërfaqe 18 m2. Pala po ashtu paguan edhe qira mujore për këtë parcelë. Në mbështetje të kërkesës pala ka paraqitur edhe ekspertizen gjeodezike duke elaboruar pretendimet e tij lidhur me ngastrën kadastrale

Parcela gjendet në ZK Llapnasellë në Komunën e Graçanicës, aktualisht karakterizohet me aktivitetet të ndryshme biznesore. Në parcelë sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve te gjeoportalit nuk ka ndërtim, përveç se një objekti të vogël ashtu sikurse është përshkruar në ekspertizën gjeodezike dhe e njëjta ngastër kadastrale ka qasje të drejtpërdrejtë në rrugë publike.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 nëntor 2024.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-214/29

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 nëntor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

**I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale 00902-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 4905 m<sup>2</sup> ZK Lubizhdë Prizren, pronë e NSh KBI Progres, me parashtruesin**

**II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Kosova Export – Ratar, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rastin nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet nuk ka dhënë shpjegime lidhur me kërkesën e paraqitur për blerje të ngastrës kadastrale mirëpo në mbështetje të kërkesës ka bashkangjitur ekspertizën gjeodezike në të cilën janë dhënë shpjegime dhe elaborime mbi pretendimet e kompanisë lidhur me ngastrën në fjalë. Në bazë të shënimeve të cilat i disponon Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren, ngastra kadastrale 902-0 me kulturë arë dhe në vendin e quajtur Plazhin me sipërfaqe prej 4905 m<sup>2</sup> është në pronësi të PSH KBI Progres, Prizren.


Në bazë të shënimeve të cilat janë dhënë në ekspertizën gjeodezike është theksuar se pala ka ndërtuar shtëpi banimi me etazhitet P+0 me sipërfaqe prej 49m<sup>2</sup>. Ngastra kadastrale 902-0 si objekt kërkesë kufizohet në veri me ngastrën 897-0 me pronar \_\_\_\_\_ në perëndim me ngastrën 901-0 me pronar \_\_\_\_\_ në jug me ngastrën 2243-0 me pronar \_\_\_\_\_ dhe në lindje me ngastrën 890-0 me pronar \_\_\_\_\_ Prizren.

Parcela gjendet në ZK Lubizhdë në Komunën e Prizrenit dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme. Në këtë parcelë aktualisht sipas pamjeve të gjeoportalit nuk shihet ndonjë ndërtim në këtë ngastër kadastrale (shënime zyrtare të vitit 2018) pavarësisht se ekspertizën gjeodezike është paraqitur se pala ka ndërtuar shtëpi banimi me sipërfaqe prej 49m<sup>2</sup> – gjë që bie në kundërshtim me nenin 4.1.2 të Rregullores, ku thuhet se: *Ndërtimet e realizuara, të cilat nuk janë të dukshme në aero incizimet e vitit 2018, kur në territorin e Republikës së Kosovës është zbatuar incizimi i fundit aerofotogrametrik, nuk do të përfshihen në proces të shitjes direkte.*

Në anë tjetër, ekspertiza gjeodezike ka paraqitur se ngastra 902-0 e cila është objekt i kërkesës së palës në anën lindore kufizohet me ngastrën 890-0 e cila është pronë e KBI Progres, Prizren e cila ka qasje direkte në rrugë publike dhe duke pasur parasysh që këtë fakt (ngastrat 902-0 dhe 890-0 janë pronë të KBI Progres) qasja

MH





në rrugë edhe ngastres 902-0 i mundësohet përmes ngastrës 890-0 ashtu të njëjta kanë qasje të pa penguar në rrugë publike.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 nëntor 2024.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-214/30

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 nëntor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të objektit në sipërfaqe prej 54 m2 (sipas listës së asetëve), pronë e NSh Ereniku Tregtia i cili gjendet në Parcelën kadastrale 2917-2 (pronë e BIK), ZK Gjakovë, me parashtruesin nga Gjakova.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Ereniku Tregtia i cili gjendet në Parcelën kadastrale 2917-2 (pronë e BIK), ZK Gjakovë, me parashtruesin nga Gjakova.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij pala ka theksuar se lokalit e ka me qira që 10 vite, në të cilin ka bërë investime në mirëmbajtjen dhe rregullimin e lokalit dhe në të cilin zhvillon aktivitetin e tij të biznesit dhe si rrjedhojë pala dëshiron ta privatizojnë të njëjtin përmes shitjes direkte.

Pala nuk ka dhënë shpjegim tjera lidhur me kërkesën e tij si dhe nuk ka prezantuar ekspertizë gjeodezike përveç se një ortofoto lidhur të parcelës me objektin në fjalë si dhe certifikatës pronësore e cila ndërlidhet me objektin në fjalë dhe e cila figuron në emër të Bashkësisë Islame.


Objekti i cila është objekt i kërkesës gjendet në ZK Gjakovë në Komunën e Gjakovës është i lëshuar me qira për palën, dhe për të njëjtin ka bërë kërkesë në Agjenci për ta blerë lokalit në fjalë përmes shitjes direkte edhe Këshilli i Bashkësisë Islame në Gjakovë, gjë e cila është pronare e parcelës ku është i ndërtuar objekti i NSh-së. Në këtë parcelë aktualisht sipas pamjeve të gjeoportalit shihet se ekziston objekti në fjalë i cili ka qasje direkte në rrugë publike.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 nëntor 2024.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-214/31

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 nëntor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të objektit në sipërfaqe prej 75.8 m<sup>2</sup> (sipas listës së asetëve) pronë e NSh Ereniku Tregtia i cili gjendet në Parcelën kadastrale 00206-2 (pronë e BIK), ZK Gjakovë, me parashtruesin nga Gjakova.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Ereniku Tregtia i cili gjendet në Parcelën kadastrale 00206-2 (pronë e BIK), ZK Gjakovë, me parashtruesin nga Gjakova.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij pala ka theksuar se lokalitë e ka në shfrytëzim që nga viti 1997. Gjatë luftës lokalitë me material të përkohshëm është djegur dhe shkatërruar, gjë të cilin pala ka theksuar se e ka rindërtuar me material të përkohshëm dhe se ka lidhur kontratë mbi qiranë me NSh-në për shfrytëzimin e tij. Pala nuk ka prezantuar ekspertizë gjeodezike përveç një ortofotoje, disa fotografi si dhe kontratën mbi qiranë me NSh-në.

Parcela gjendet në ZK Gjakovë në Komunën e Gjakovës. Objekti i cili gjendet në këtë parcelë është i lëshuar me qira, dhe për të njëjtin ka bërë kërkesë në Agjenci për ta blerë lokalitë në fjalë përmes shitjes direkte edhe Këshilli i Bashkësisë Islame në Gjakovë, gjë e cila është pronare e parcelës ku është i ndërtuar objekti i NSh-së. Në këtë parcelë aktualisht sipas pamjeve të gjeoportalit shihet se ekziston objekti në fjalë i cili ka qasje direkte në rrugë publike.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 nëntor 2024.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-214/32

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 nëntor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale P. 00152-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 4410 m<sup>2</sup> ZK Fushë Kosovë, pronë e NSh Bujqësia, në Fushë Kosovë me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e e NSh Bujqësia, në Fushë Kosovë me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij pala ka theksuar se Kompania Tregtia SHPK e ka ndërtuar fabrikën për prodhimin e betonit në parcelën e saj e cila ndodhet në afërsi të parcelës për të cilën ka bërë kërkesë. Në parcelën 152-0 për të cilën kompania ka bërë kërkesë, nga reshjet e shiut grumbullohet uji dhe krijohet një bazën, dhe rrjedhimisht këtë ujë të grumbulluar kompania e ka marrë dhe përdorur për procesin e prodhimit të betonit.

Në anën tjetër në kërkesë, po ashtu është theksuar se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për vazhdimin e punës në fabrikë ka kërkuar pajisjen me leje ujore, dhe si rezultat i kësaj rrethane kompania ka kërkuar përmes kërkesës që të bëj blerjen e kësaj parcele apo marrjen me qira të së njëjtës. Në mbështetje të kërkesës pala ka paraqitur ekspertizën gjeodezike përmes së cilës ka elaboruar kërkesën e tij lidhur me parcelën në fjalë. Parcela gjendet në ZK Fushë Kosovë dhe sipas pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndërtim, mirëpo e njëjta nuk ka qasje në rrugë. Në të njëjtën shihet se ekziston një pellg uji ashtu sikurse është paraqitur në kërkesë.

Rrjedhimisht, nga shkruesat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 nëntor 2024.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-214/33

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 nëntor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

### I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të:

1. Objektiv/Lokal Afarist dhe Depo nr.1 me sipërfaqe prej 300 m2 në pronësi të NSH Liria
2. Objektiv/Lokal afarist dhe Depo nr.2 me sipërfaqe prej 650 m2 në pronësi të NSH Liria

### II. Refuzohen të pa pranueshme në mungesë të juridiksionit kërkesa për blerje direkte të parcelat kadastrale si në vijim::

1. Parcelës Nr. 7077-0, me sipërfaqe 2219 m2 dhe
2. Parcelës Nr. 7079-0, me Sipërfaqe 1965 m2,

Që të gjitha në ZK Prizren, Komuna Prizren, të cilat evidentohen në emrin e NSH "Liria" në Prizren, me parashtruesin

### III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.


## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh "Liria" në Prizren, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se duke qenë se pala kërkesën e vet të datës 14.05.2019, e ka bazuar vetëm mbi bazën e investimit apo renovimit dhe adaptimit për përshtatje nevojave të afarizmit të tij për pronën në të cilën ka hyrë në posedim të pronave në bazë të kontratave të qirasë të lidhura në vitin 2017, sipas së cilave janë dhënë me qira Lokali Afarist, Depo nr.1 dhe Depo nr 2, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 950 m2. Kërkesa e palës është për zhvillimin e veprimtarisë në objektet dhe ngastrat e lartcekura.

Nga ana tjetër, bazuar në shkresat e lëndës mund të kuptohet se parcelat në rastin konkret formojnë së bashku një tërësi të patundshmërisë, mbi të cilat gjendet një objekt po ashtu i NSh "Liria". Parashtruesi e ka shpjeguar faktin se i njëjti është në posedim apo shfrytëzim të objekteve dhe tokës mbi bazën e kontratës së qirasë, mirë po ky raport është qiramarrës dhe qëllimi është shfrytëzimi për nevoja afarist ndërsa Rregullorja për shitje direkte nuk e kualifikon për shitje direkte të pronës për faktin se është qiramarrës. Objektet lokalet afariste dhe depot janë prona të cilat gjatë gjithë kohës kanë ekzistuar dhe janë përdorur me destinim komercial. Pavarësisht faktit se pala deklaroi se ai ka bërë investimet në renovim apo adaptim, korniza ligjore, këtë kërkesë nuk e kualifikon si kërkesë për aset specifik rrjedhimisht nuk mund të jetë objekt i shtijës direkte.



Lidhur me pjesën e dytë të kërkesë, blerja direkte e parcelave kadastrale, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin NR.08/L-137 PËR PYJET e që sipas nenit 8 të këtij ligji është përcaktuar në mes tjerash që edhe pronat NSH “Ekonomia e Pyjeve” kanë kaluar në pronësi shtetërore të Republikës së Kosovës. Kjo nënkupton se AKP tashmë nuk ka juridiksion për të vendosur për pronat të cilat janë pronësi shtetërore të cilat menaxhohen nga Agjencia e Pyjeve. Rrjedhimisht kërkesa për blerje direkte nuk mund të jetë objekt shqyrtimit apo vendosjes nga Agjencia. Kërkesa sa i përket parcelave në fjalë duhet të refuzohet si e pa pranueshme.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 nëntor 2024.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-214/34

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 nëntor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të pjesës në bashkëpronësi të Parcelës Nr. 1073-1, me sipërfaqe të përgjithshme 1847 m<sup>2</sup>, dhe shitjes së Njësive të Ndërtesës, të cilat në evidencën kadastrale janë të regjistruara në pronësi të NSh Bankos – Banka Themelore në Pejë, ZK Pejë, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Bankos – Banka Themelore në Pejë, ZK Pejë, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se duke qenë se pala kërkesës e vet e ka bazuar vetëm mbi faktin se me 18.03.2021, ' ' ka ushtruar kërkesë për privatizimin e Parcelës Nr.1073-1, sipërfaqe 1847 m<sup>2</sup> dhe Njësive të Objektivit, të cilat së bashku me parcelën e cituar evidentohen në emrin e NSH. Parashtruesi ka theksuar se është pronar i dy kateve të këtij Objekti dhe në mënyrë proporcionale dhe bashkëpronar i Parcelës lëndore mbi të cilën ekziston Objekti. Në fakt, nisur nga bodrumet kjo Ndërtesë përfshinë 17-të Njësi dhe evidentohet si Bankos - Banka Themelore e Pejës. Mbi bazën e pohimeve si më sipër parashtruesi konsideron se ka të drejtë ta privatizoj pjesën tjetër të Parcelës dhe katet tjera të kësaj Ndërtese.

A] Parashtruesi është i regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare me 26.06.2009, me numër 810548399, Në faqe 5, të Informatave mbi biznesin konstatohet se themelues i këtij entiteti, tani parashtrues, është . Ndërsa kjo e fundit është regjistruar në Shkup, Republika e Maqedonisë Veriore me numër [EMBS] 7333161, sipas Vendimit, i lëshuar me 01.09.2020

B] Evidenca Kadastrale - Në ekspertizën e gjeodezisë shpjegohet se Ndërtesa e Bankës Themelore të Pejës, përbëhet nga pjesët bazike: A] Bodrumi; B] Ndërtesa shumëkatëshe, përbërja e të cilave është prezantuar si më sipër [Kapitulli: Të dhënat për asetin] pa nevojë të përshkruhen sërish. Sipas shkresave të kësaj lënde vërehet se parashtruesi, respektivisht DM SHPK [me shënime si më sipër] figuron si pronar i pjesëve të cilat përshkruhen si në vijim:

- 1) O-71611071-01073-1-58-1-1-0, S=45 m<sup>2</sup> [kati përdhese]
- 2) O-71611071-01073-1-58-1-5-0, S=106.46 m<sup>2</sup> [kati i dytë]
- 3) O-71611071-01073-1-58-1-6-0, S=106.54 m<sup>2</sup> [kati i dytë]
- 4) O-71611071-01073-1-58-1-7-0, S=106.46 m<sup>2</sup> [kati i tretë]
- 5) O-71611071-01073-1-58-1-8-0, S=106.46 m<sup>2</sup> [kati i tretë]

Të gjitha këto me sipërfaqe të përbashkët 470.92 m<sup>2</sup>





**C] Ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë**

Sipas ekspertizës gjeodezike dhe Certifikatave pronësore, konstatohet se komplet Parcela lëndore dhe pjesët tjera të kësaj Ndërtese të cilat janë radhitur në gjithsejtë 17-të Njësi, evidentohen të gjitha këto (sipas evidencës kadastrale) në emrin e Bankës Themelore të Pejës. Kështu sipas të gjitha këtyre certifikatave të pronësisë, [matjeve dhe identifikimit të tyre sipas ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë, rezulton se:

1. Në emrin e parashtruesit i ..... evidentohet 5/pesë Njësi, prezantuar si më sipër me sipërfaqe 470.92 m<sup>2</sup>;
2. Në emrin e NSH-së Banka Themelore Pejë, evidentohen:  
(1) Parcela Nr. 1073-1, me sipërfaqe 1847 m<sup>2</sup>, Dhe  
(2) 17-të Njësi, me sipërfaqe të përgjithshme 2258.51 m<sup>2</sup>

**D] Pretendimet e Parashtruesit**

Parashtruesi ka theksuar se, cituar: “kalimi nëpër katet e larta të ndërtesës, duhet të bëhet vetëm përmes zyrave [kateve] të kompanisë sime, andaj duke e ditur shtrirjen dhe pozicionimin e kateve vlerësojmë dhe mendojmë që kjo do të jetë më normë të jashtëzakonshme të zhvlerësimit të vlerës së këtyre kateve”. Në vijim të kërkesës ka shpjeguar se ka ushtruar kërkesë për blerje me negociim të drejtë për drejtë të të gjitha kateve të kësaj ndërtese, sepse sipas tij/sajë, cituar: “kjo do të jetë në interesin më të mirë të NSH Bankos dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit si administratore dhe se, cituar: “ky është i vetmi model ku do të maksimizohet vlera e këtyre ngastrave (v.j: kateve) në situatën momentale”. Kurse arsye tjetër e ushtrimit të kërkesës është zgjerimi i biznesit të parashtruesit në pjesët tjera të kësaj Ndërtese.

E] Shqyrtimi i pretendimeve - Agjencia konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk ka bazë juridike në institutin e “bashkëpronësisë” për privatizimin e këtyre asetëve përmes shitjes direkte, ngase parashtruesi nuk është bashkëpronar në njësitë individuale të ndërtesës të cilat i takojnë NSH si pronare. Sipas Ligjit mbi pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, e drejta e kalimit nëpër hapësira të përbashkëta konsiderohet e drejtë reale nga e cila nuk mund të privohet asnjëri nga bashkë/pronarët. Shtrirja e kateve, për të cilat parashtruesi mendon se shitja direkte është sipas tij, i vetmi model ku do maksimizohet vlera e tyre, konsiderohet se nuk është reale ngase Ndërtesa e kësaj Banke ka qenë gjithnjë e tillë dhe asnjëherë nuk është konstatuar se pozicioni apo shtrirja e tillë e kateve krijon efekt zhvlerësimi ngase një fakt i tillë është prezent për çdo godinë shumëkatëshe, sepse lëvizjet nga një njësi në tjetrën, bëhen gjithnjë nëpër hapësirat e përbashkëta, të destinuara si shkallë, korridore e tjera të ngjashme të cilat nuk konsiderohen pronë ekskluzive e njërit bashkëpronar [me përjashtim të atyre rasteve kur ata me pajtimin unanimit vendosin ndryshe].

Bazuar në të lartcekurat, konsiderohet nuk përbën interes për NSH-në që bashkë/pronësia mbi Parcelën dhe/ose pronësia mbi 17-të njësitë e saja të bartet te ndonjë subjekt tjetër. E drejta e pronësisë mbi Ndërtesën [17-të njësi] dhe mbi Parcelën lëndore, duhen ruajtur tani për tani si pasuri komplete e NSH-së, me supozimin se si të tilla krijojnë efekte në ruajtjen e vlerës reale në interes të NSH.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 nëntor 2024.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-214/35

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 nëntor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës Nr. 7353-1, dhe pjesës përkatëse të Objektit Nr. 7353-1-203-0 (me sipërfaqe 484 m<sup>2</sup>) ZK Prishtinë, në pronësi të NSH "Duhani" me seli në Prishtinë, me parashtruesen - NTP Fellini nga Prishtina.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSH "Duhani", me parashtruesen - NTP Fellini nga Prishtina..

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm mbi faktet sikurse në vijim:

1. Në vitin 2001, në marrëveshje me NSH, parashtruesi ka marrë lokalet lëndore në shfrytëzim me qira, në emër të entitetit afarist "Pastiqeria Fellini" dhe ka investuar një shumë të konsiderueshme të mjeteve për riparimin dhe aftësimin e këtyre hapësirave. Nga ajo kohë, parashtruesi si pronar i këtij entiteti afarist i ka përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet e qirasë dhe ka angazhuar në punë afërsisht 14 persona. Me Vendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë IC.Nr.108/2008 dhe Vendimin e Autoritetit të Likuidimit, datë 23.06.2010, parashtruesit i është njohur e drejta për kompensimin e investimeve në shumën 185,766.35 €, me kamatë vjetore 3.5%.

2. Ndërkohë, parashtruesi i është drejtuar Bordit dhe Menaxhmentit të AKP-së me kërkesat e datës 08.05.2012 dhe 16.10.2018 për blerjen e këtij lokali me negocim direkt, bazuar paraprakisht në propozimin e AL.

Në fakt, nga dy shkresat e cituara si më sipër nënkuptohet se AL e ka ngritur iniciativën për blerjen direkte të këtij lokali me synimin që nga arka e NSH-së të mos paguhet borxhi si më sipër, përkundrazi parashtruesit ti ofrohet blerja e të njëjtit lokal kurse nga vlera e transaksionit eventual të shitblerjes të zbritet shuma e këtij borxhi. Për këto arsye parashtruesi i është drejtuar Bordit dhe Menaxhmentit të AKP-së me shkresat e cituara si më sipër, për blerjen e këtij lokali me anë të negocimit direkt.

3. Me 03.02.2017, Agjencia e ka njoftuar parashtruesin se, cituar "AKP e ka marrë në konsideratë kërkesën tuaj dhe do ta shqyrtoj në një afat sa më optimal sapo të funksionalizohet Njësia përkatëse dhe aktet nën-ligjore për shqyrtimin e kërkesave të tilla". Me 07.11.2018, bazuar në udhëzimet dhëna nga ana e kësaj Agjencie, parashtruesi e ka plotësuar kërkesën dhe ka dorëzuar ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë e cila pasqyron gjendjen faktike lidhur me parcelën lëndore 7353-1, dhe objektin aktual 7353-1-203-0, nga i cili 49 m<sup>2</sup>, figurojnë në emër të personit fizik Hasan Hasani, kurse pjesa tjetër prej 484 m<sup>2</sup>, shfrytëzohet nga biznesi i parashtrueses por edhe nga entiteti "Morena" bar-caffe.




4. Me 17.04.2019, AKP e ka njoftuar sërish parashtruesin "...do të njoftoheni me kohë lidhur me rrjedhën e mëtejme të procedurës dhe ndërmarrjen e veprimeve eventualisht të nevojshme..."

5. Ndërkohë, gjatë shqyrtimit të kërkesës, është konstatuar dhe të dhënave nga arkivi i NSh-së dhe/ose të kësaj Agjencie, se parashtruesit i është paguar shuma e cituar si më sipër në emër të borxhit, sipas vendimit të AL i datës 23 qershor 2010 për njohjen e investimeve dhe memos për pagesën e kreditorëve i datës 21.02.2023 sipas Raporti të shpërndarjes të përkohshëm të pjesshëm.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për inicimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.  
Prishtinë, më 15 nëntor 2024.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD-214/36

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 nëntor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

### I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të:

- Parcela kadastrale P-70705029-00206-1 me sipërfaqe të përgjithshme 3721 m<sup>2</sup>, në pronësi të NSH "Ereniku Prodhimtaria Primare" Gjakovë;
  - Objekti shtëpi ndërtesë me sipërfaqe prej 1312 m<sup>2</sup> në pronësi të NSH "Industria";
  - Sipërfaqja prej 500 m<sup>2</sup> me kulturë oborr në pronësi të NSH "Ereniku Prodhimtaria Primare" Gjakovë;
- ZK Gjakovë me parashtruesin Subjekti Juridik "Litografia" i cili përfaqësohet nga \_\_\_\_\_ nga Gjakova.

### II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSH "Industria" dhe NSH "Ereniku Prodhimtaria Primare" Gjakovë me parashtruesin Subjekti Juridik "Litografia" i cili përfaqësohet nga \_\_\_\_\_ nga Gjakova.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se duke qenë se pala kërkesën e vet të datës 12.04.2024 e ka bazuar vetëm mbi deklaratën se pretendimi i tij për blerje direkte bazohet në "marrëveshjen" për shitblerje e arritur në mes të dy subjekteve "Litografia" kompani private e cila ishte themeluar në vitin 1990 dhe regjistruar në Gjykatën Ekonomike në Gjakovë Fi.2748/91 dt 06.11.1991, e cila pas themelimit ishte bashkuar me Ndërmarrjen për punë grafike dhe qarkullim "Colorprint" Gjakovë me Nr. regjistrimit Fi.408/89 dt 20.12.1989; e cila sipas parashtruesit, e zhvillonte veprimtarinë në paluajtshmërinë e cila është objekt i kërkesës që nga ajo kohë. Tutje pala e shpjegon procedurën për blerjen e që sipas deklaratës së parashtruesit Komisioni për ndërrime dhe shitblerjeje i KB "Ereniku" e kishte aprovuar shitblerjen. Pala thekson se Litografia kishte paguar shumën prej 500,000.00 dinar nga shuma e përgjithshme për shitblerjen e paluajtshmërive në shumë totale 700,000.00 dinar. Në vazhdim pala shpjegon edhe një raport transaksioni në mes të dy kompanive private "Colorprint" dhe "Litografia" për shitblerjeje të aksioneve, mirëpo kjo është jo relevante për meritat e rastit. Pala gjithashtu përshkruan edhe për procesin gjyqësor lidhur me pretendimet e tij pronësore, duke përmbyllur në fund me gatishmërinë e tij për blerje direkte pavarësisht faktit siç thekson ai, se këtë pronë tashmë e ka blerë.

Pala aktualisht është në posedim të pronës mbi bazën e kontratës së qirasë e lidhur në mes të AKP-së dhe parashtruesit të kërkesës.

Nga vetë shkresat e lëndës dhe deklarata e palës, kuptohet se ai është në posedim të kësaj pronës tash e një kohë të gjatë në bazë të marrëveshjeje të fillimisht subjektit juridik privat "Colorprint" e më vonë "Litografia".




Pala marrëveshjes i referohet si shitblerje mirëpo nga provat materiale në shkresa të lëndës por edhe atyre të siguruara nga Agjencia ku konstatohet se parashtruesi e kishte marr me qira pronën fakt ky që vërtetohet edhe nga deklarata përfaqësuesit të NSh "Emin Duraku", e dhënë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, sipas së cilës theksohet se paditësi (Litografia) pronën e kishte me qira dhe se NSh-ja nuk kishte lidhur asnjëherë me askënd kontratë të shitblerjes për pronën kontestuese DhPGjS me Aktgjykimin e datës 22 prill 2024, e ka refuzuar padinë e palës në tërësi si të pa bazuar dhe ka konstatuar se pretendimet e palës për vërtetim pronësie nuk qëndrojnë.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.  
Prishtinë, më 15 nëntor 2024.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-214/37

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 nëntor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të lokalit afarist me sipërfaqe 95 m<sup>2</sup>, i cili në regjistrin kadastral evidentohet në emër dhe pronësi të NSh "Shoqata Zejtare e Berberëve "Ardhmëria" [ish-Buduqnost] ZK Pejë, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh "Shoqata Zejtare e Berberëve "Ardhmëria" [ish-Buduqnost] me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se duke qenë se pala kërkesën e vet të datës 12.04.2024 e ka bazuar në faktet sikurse në vijim:

A] Me 27.11.2017, parashtruesi ka dorëzuar në AKP, një kërkesë për blerjen e pronës së Kooperativës së Berberëve në Pejë, me emrin "Ardhmëria" [me parë Buduqnost], e cila ndodhet në Parcelën Nr. 1063 dhe evidentohet në emrin e kësaj Ndërmarrje. Në fakt, bëhet fjalë për dyqanet e kësaj ndërmarrje me sipërfaqe 95 m<sup>2</sup>, të cilat gjenden në Sheshin e Qytetit, në Rrugën "Mbretëresha Teutë" Nr.37. Në mbështetje të kësaj kërkesë, parashtruesi mes tjerash ka shpjeguar siç vijon:

1. Me 07.05.2008, parashtruesi ka lidhur një marrëveshje me këtë Shoqatë për marrje me qira të këtij lokali, duke shpjeguar se është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Pejë me 08.05.2008, Nr. 2754/08, kurse Aneksi i kësaj kontrate është vërtetuar me 28.05.2010, Nr. 3283/10]. Mbi bazën e kësaj marrëveshje parashtruesi e ka marrë lokalin lëndor në shfrytëzim 10 vjeçar, për shumën 20.000 €
2. Me 07.12.2010, mbi bazën e Kontratës së cituar si më sipër dhe për të njëjtin lokal, ka lidhur Kontratë për dhënie me qira me Bankën NLB Prishtina, e cila është vërtetuar në të njëjtën Gjykatë me 21.12.2010, Nr. 9789/2010. Më tej, parashtruesi ka theksuar, cituar: "...pas ndërhyrjes së AKP-së jam detyruar të hyjë në marrëveshje të qirasë me AKP..."

Pa nevojë në këtë rast, për të cituar dispozita të caktuara të këtyre kontratave, konstatohet padyshim se parashtruesi ka vepruar në kontekstin e rrethanave të shpjeguara shkurt si më sipër, i cili sipas Kontratës së Qirasë, e vërtetuar me 16.04.2016 [Protokolli: 1845] dhe Aneksit të kësaj kontrate datë 23.11.2017 [Nr. 2958/2017] paguan tani qira mujore në llogarinë e NSH-së në shumën 140€.

B] Krahas shpjegimeve si më sipër por njëherësh nisur dhe nga detyrimi ligjor i kësaj Agjencie për ndriçimin e drejtë të çështjes në rastin konkret, Agjencia ka siguruar po ashtu dhe disa prova në dispozicion të kësaj Agjencie, mes tjerash dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Pejës C. Nr. 384/12, të datës 12.05.2014.

1. Në fakt sipas këtij Aktgjykimi, e duke vendosur lidhur me Padinë e AKP-së, konstatohet se:

- Gjykata i ka anuluar në tërësi dy akte kontraktuese të lidhura mes parashtruesit dhe NSH-së; Dhe





- E ka anuluar pjesërisht, Kontratën mbi Qiradhënien e lokalit afarist e cila ishte lidhur mes parashtruesit dhe Bankës NLB Prishtina.

2. Në të vërtetë, Gjykata pjesërisht e ka anuluar kontratën e cituar si më sipër kurse pjesërisht e ka refuzuar Padinë e kësaj Agjencie, për faktin parimore se:

- NLB Prishtina, nga cilësia e saj si ndërhyrës në këtë çështje kontestuese, ishte palë e tretë në raportet kontraktuese mes parashtruesit dhe NSH-së;
- Dhe se, për një serë rrethanash pa nevojë për ti komentuar e njëjta objektivisht ka konsideruar se aktet kontraktuese /të anuluar/ janë të ligjshme, përderisa ato ishin vërtetuar pranë kësaj Gjykate.

C] Gjatë shqyrtimit të kërkesës, përmbajtjes së sajë dhe pretendimeve të parashtruesit, e duke i administruar, krahasuar dhe analizuar dhe njëherësh të gjitha provat në dispozicion, konstatohet se arsyeja kryesore mbi bazën e të cilave Ai ia ka realizuar veprimet e shpjeguara si më sipër bazohen kryesisht në deklarinimin e tij se, cituar: “Nuk kam pasur dijeni se kjo pronë është në administrimin e AKP-së”.

Mirëpo në këtë rast, duhen prezantuar faktet në vijim:

1. AKP, më parë AKM, ishte themeluar në vitin 2002, e cila që atëherë ishte shndërruar në një fakt notor-publikisht të njohur përfshirë pa dyshim dhe parashtruesin.
2. Këto veprime i referohen vitit 2008 dhe 2010, që d.t.th 8/tetë vite pas themelimit të Agjencisë. Parashtruesi në fakt, kishte ndërmarrë veprime të kësaj natyre me një ndërmarrje si palë kontraktuese, e cila dihej publikisht se tani më veç ishte nën administrimin e AKP-së, përderisa statusi i sajë ishte përcaktuar që në vitin 2005, fakte këto padyshim të njohura sidomos për drejtuesit e kësaj NSH-je dhe rrjedhimisht për parashtruesin po ashtu.

D] Në vijim të kërkesës Parashtruesi ka theksuar se ka bërë investime në lartësi 10.000 € nga të cilat është dyfishuar vlera e këtij lokali. Mirëpo, investimet pavarësisht lartësisë janë bërë pa bazë ligjore dhe/ose pa miratimin paraprak të AKP-së, fare pa nevojë për komente tjera dhe/ose fare pa nevojë për të cituar dispozita përkatëse të ligjeve përkatëse, qoftë të Ligjit për AKP-në, atij për detyrimet apo legjislacionit pronësor, përderisa të tilla meremetime janë bërë pa nevojë në “sendin e huaj”.

Në kontestin e fakteve dhe rrethanave të shpjeguara si më sipër, kërkesa e parashtruesit nuk ka bazë ligjore, përveç shpjegimeve si më sipër dhe për faktin parimor se:

1. Ligji për AKP-në dhe Rregullorja Nr. 4/2024, për shitjen direkte të aseteve të caktuara të ndërmarrjeve shoqërore, nuk i njohin shpenzimet dhe/ose veprimet e tilla, të palejuara më parë dhe për interesa të parashtruesit të kërkesës, si bazë për iniciimin e shitjes direkte;
2. Sipas Ligjit mbi pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, e drejta e pronësisë është e drejtë reale me karakter absolut, nga e cila nuk mund të privohet asnjë pronar, përfshirë dhe NSH-të, pavarësisht ndonjë renovimi eventual;


Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.  
Prishtinë, më 15 nëntor 2024.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues/  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-214/38

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 nëntor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

I. Për kërkesat për blerje direkt të përshkuara si më poshtë, në mungesë të kompetencës ligjore mbi paluajtshmërit objekt i kërkesave, Agjencia Kosovare e Privatizimit shpallet jo kompetente për vendim marrje për kërkesat :

- i) – Kërkesa për blerje direkte Nr. 611 e parashtruar me datën 02 shkurt 2019, për parcelat kadastrale P-70806020-00213-1, P-70806020-00213-4, P-70806020-00213-7, P-70806020-00213-8, P-70806020-00213-9 si dhe P-70806020-00213-10, me sipërfaqe të përgjithshme prej 25623 m2 të cilat gjendet në zonën kadastrale Istog Komuna e Istogut;
- ii) – Kërkesa për blerje direkte Nr. 17725 e parashtruar me 19 janar 2021, për parcelat kadastrale P-72116046-02307-2, P-72116046-02313-0, P-72116046-02314-0 dhe P-72116046-02315-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 305359 m2 të cilat gjenden në zonën kadastrale Suharekë, Komuna e Suharekë.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Memorandumin e Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin propozohet deklarimi i jo kompetencës për shqyrtimin e kërkesave për blerje direkte. Divizioni i Shitjes Direkte (DSHD), gjatë shqyrtimit të kërkesave të parashtruara nga palët në periudha të ndryshme kohore, ka gjetur se për shkaqe të ndryshme, pronat të cilat kanë qenë objekt i këtyre kërkesës për blerje e të cilat në kohën e parashtrimit të kërkesave ishin në pronësi të Ndërmarrjeve Shoqërore, tashmë kanë kaluar në pronësi publike – shtetërore.

Marrë parasysh këtë gjendje të re faktike dhe juridik për pronat të cilat ishin objekt i kërkesave nga palët, si dhe duke u bazuar në dokumentacionin relevant juridiko pronësore për këto parcela kadastrale, Agjencia, nuk ka më juridiksion për shqyrtimin e tyre apo të vendos lidhur me kërkesat. Kjo nënkupton se tek këto dy kërkesa nuk ka më lëndë shqyrtimi. Me që lëndët janë aktive tek DSHD është që të ju jepet epilog si kërkesa.

Në këtë vendim janë paraqitur dy kategori të rasteve pronësore të cilat si rezultat i ndryshimeve ligjore, dhe vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës ku pronat kanë kaluar tek organet publike.

- a) Rasti gjashtë parcela kadastrale largohen nga mandati i AKP-së si rezultat i miratimit të Ligjit për Pyjet e Kosovës Nr. 08/L-137, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dt 03 prill 2023.
- b) Rast kate parcelat kadastrale në bazë të Vendimit për shpronësim të Qeverisë së Republikës së Kosovë për Zone e Interesit Publik për Ministrin e Mbrojtjes të parcelave të përshkuara si në pikën 6, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shpronësimin kalojnë pronë shtetërore në Republikën e Kosovës.

Përveç gjendjes faktike të krijuar mbi asetin, marr parasysh edhe kornizën ligjore të aplikueshme për shpronësimin, këmbimin respektivisht kompensimin e pronave për interes publik, Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative si dhe dispozitat e ligjit të AKP-së, gjendjen faktike në terren mbi asetin në fjalë,



Agjencia konsideron se zgjidhja më e mirë aktuale është që të shpallet jo kompetent për rastet sipas përshkrimit në pjesën për vendim.

Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 nëntor 2024.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-214/39

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullores Nr.15/2023 e Divizionit të Shqyrtimit të Ankesave në Listat e 20% të Punëtorëve (DShALP), sipas nenit 72.5 dhe 72.6 të Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 15 nëntor 2024 nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet lista përfundimtare e punëtorëve të NSh "Përparimi" Prishtinë, (PRN111), e bashkëngjitur në shtojcën 1;
- II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të publikoj Listën përfundimtare, të aprovuar më lartë, sipas nenit 72.5 dhe 72.6 e Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe sipas Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

### Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në listën përfundimtare të punëtorëve të Aprovohet Lista përfundimtare e punëtorëve të NSh "Përparimi" Prishtinë, (PRN111).


Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullave të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave ndaj Listave të Punëtorëve (KSHALP), Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 nëntor 2024

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-214/40

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullores Nr.15/2023 e Divizionit të Shqyrtimit të Ankesave në Listat e 20% të Punëtorëve (DShALP), sipas nenit 72.5 dhe 72.6 të Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 15 nëntor 2024 nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet lista përfundimtare e punëtorëve të “Enti për Përparimin e Amvisërisë” Prishtinë (PRN189) e bashkëngjitur në shtojcën 1;
- II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të publikoj Listën përfundimtare, të aprovuar më lartë, sipas nenit 72.5 dhe 72.6 e Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe sipas Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

### Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në listën përfundimtare të punëtorëve të Aprovohet Lista përfundimtare e punëtorëve të NSh “Enti për Përparimin e Amvisërisë” Prishtinë (PRN189).


Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullave të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave ndaj Listave të Punëtorëve (KSHALP), Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.  
Prishtinë, më 15 nëntor 2024

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-214/41

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullores Nr.15/2023 e Divizionit të Shqyrtimit të Ankesave në Listat e 20% të Punëtorëve (DShALP), sipas nenit 72.5 dhe 72.6 të Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 15 nëntor 2024 nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet lista përfundimtare e punëtorëve të NSh “Stacioni i Veterinarisë” Gjakovë (PEJ097) e bashkëngjitur në shtojcën 1;
- II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të publikoj Listën përfundimtare, të aprovuar më lartë, sipas nenit 72.5 dhe 72.6 e Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe sipas Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

### Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në listën përfundimtare të punëtorëve të Aprovohet Lista përfundimtare e punëtorëve të NSh “Stacioni i Veterinarisë” Gjakovë (PEJ097);

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullave të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave ndaj Listave të Punëtorëve (KSHALP), Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 nëntor 2024

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-214/42

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullores Nr.15/2023 e Divizionit të Shqyrtimit të Ankesave në Listat e 20% të Punëtorëve (DShALP), sipas nenit 72.5 dhe 72.6 të Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 15 nëntor 2024 nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet lista përfundimtare e punëtorëve të NSh "Centrotekstil" Prishtinë (PRN190) e bashkëngjitur në shtojcën 1.
- II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të publikoj Listën përfundimtare, të aprovuar më lartë, sipas nenit 72.5 dhe 72.6 e Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe sipas Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

### Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në listën përfundimtare të punëtorëve të Aprovohet Lista përfundimtare e punëtorëve të NSh "Centrotekstil" Prishtinë (PRN190).

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullave të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave ndaj Listave të Punëtorëve (KSHALP), Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi shqyrëtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 nëntor 2024

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-214/43

